

Shkodra - një qendër albanologjike në prag të pavarësisë

Shkodra, dashunorja e shekujve!
Migjeni

Në punimin tim jam orientuar në dy dimensione: *Pavarësia e Shqipërisë* dhe *Albanologjia*, duke i bashkëlidhur këto me një dimension të tretë: *Shkodrën*, një qendër e fuqishme urbane, që mëton prej kohësh statusin e një qendre po aq të fuqishme universitare e me një institut kërkimesh, i cili jo rastësish ka rrokur ndërkohë përmasat e një rrjeti shkencor-albanologjik të mirëfilltë. Këtë triptik dimensionesh e kam kufizuar në aksin kohor, duke u fokusuar në ato rrethana të hulumtimit albanologjik në Shkodër që përshkojnë periudhën deri në prag të shpalljes së pavarësisë. Është një periudhë kjo që jemi mësuar ta damkosim jo rrallë, por patëkeq, si *parashkencore*, edhe pse jemi më se të vetëdijshëm se është pikërisht kjo periudhë, kur në hapësirën kompakte shqipfolëse u hodhën themelët e para për shumë disiplina që formëzojnë sot së bashku fushën komplekse të albanologjisë shqiptare.

C'vend zë Shkodra në historinë e albanologjisë pikërisht në këtë periudhë? Një pyetje kjo që vjen natyrshëm, po të marrim në analizë zhvillimet që përjetoi kërkimi albanologjik në arealin kulturor shqipfolës përgjatë gjysmës së dytë të shek. XIX deri në prag të shpalljes së pavarësisë. Dhe studimet e mirëfillta në këtë drejtim nuk është se kanë munguar. Mjafton të citoj këtu përfundimet e konferencave me përmasa ndërkombëtare "Shkodra në shekuj" (Shkodër 1995), pa dashur assesi t'u anashkaloj sadopak prurjeve të bollshme e në vazhdimësi të shkollës *në zâ* të filologëve dhe bibliografëve të Shkodrës, e cila zuri rrënëjë të forta me Át Engjëll Radojën e P. Anton Xanonin; hodhi shtat me Át Justin Rrotën, Át Filip Fishtën, Át Benedikt Demën, Át Donat Kurtin, e më pas me Kolë Ashtën, Injac Zamputin e Jup Kastratin, për të vijuar në kohën tonë me punën e palodhshme të Willy Kamsit, Tomor Osmanit, David Lukës, Tefik Topallit, Mentor Qukut etj. Janë pikërisht këto prurje, që lejojnë tash të ngjizim natyrshëm bindjen – sado të guximshme që mund të duket në pamje të parë – se, për periudhën në fjalë në gjithë hapësirën kompakte shqipfolëse spikat qyteti i Shkodrës si qendër kulturore-urbane, e cila i dha tonin

kësaj faze zhvillimi të debatit albanologjik, përkatësisht formëzimit të albanologjisë shqiptare si fushë komplekse ndërdisiplinore.

Këtë fazë të parë e kam bërë objekt diskutimi në këtë studim, duke e këqyrur nga disa perspektiva, ndër të tjera:

- a) në hetimin e faktorëve të jashtëm, qofshin këta politikë e kulturorë-historikë, që mundësuan lindjen dhe zhvillimin e hulumtimit albanologjik në këtë qytet në periudhën në fjalë; e në bashkëlidhje më këtë
- b) në bashkërendimin e aktivitetit intelektual me angazhimin social, që nxitën përfimin e një organizimi institucional sado rudimentar të vetë hulumtimit; duke tentuar me këtë rast edhe
- c) një përqasje me nivelin e debatit albanologjik në Europën e kësaj periudhe.

Sigurisht që për të arritur një rezultat paraprak pamë më se të nevojshme t'i përbaheshim skemës së thjeshtë e të përgjithshme të lindjes dhe zhvillimit të një fushe ndërdisiplinore çfarëdo, e cila parakupton fillimisht:

- përcaktimin të objektit si edhe
- nevojën e mundësitë aktuale të hulumtimit të tij nga disa këndvështrime, përkatësisht
- përpilimin e metodave sa më efikase në mbledhjen, organizimin dhe klasifikimin e materialit (p.sh. gjuhësor, dokumentar-historik, arkeologjik, etnologjik etj.); duke mundësuar gjithashtu
- përgatitjen dhe formimin rishtarëve (adeptëve), të cilët thellojnë më tej atë hulli studimi; çka siguron në të njëjtën kohë
- vazhdimësinë e nevojshme në hulumtim, e gjen kështu shprehjen
- në përfimin e qendrave të mirëfillta kërkimore-shkencore, përkatësisht
- në zhvillimin e një bashkëpunimi kolegjal deri
- në përfimin e një infrastrukturë ndërinstitucionale për disiplinën a disiplinat në fjalë.¹

1. Shkodra - qendër kryesore urbane në suazën e Protektoratit Kulturor

Duke iu përbajtur kësaj skeme, dallojmë fillimisht një faktor të fuqishëm politik-kulturor që mundësoi qysh herët lindjen dhe zhvillimin e debatit albanologjik në këtë qendër urbane, e cila deri në

¹ Khs. Nicholas MULLIN 1974 (1972) 184vv. Për zhvillimet që përfjetoi në rrjedhë të kohës albanologjia si shkencë gjuhësore historike, shih. Hermann ÖLBERG 1982 135vv.

prag të shpalljes së pavarësisë (madje deri në përfundimin e Luftës së Parë Botërore) ishte përfshirë në sferën e të ashtuquajturit Protektorat Kulturor (= gjerm. *Kultusprotektorat*). Pa dashur të thellohem i në fillimet e ndërmarrjes së këtij misioni afatgjatë,² mund të pohojmë paraprakisht se për periudhën në fjalë ai gjellinte atëbotë qoftë në marrjen në mbrojtje të popullsisë së krishterë nga keqtrajtimi i mundshëm prej autoritetit shtetëror-administrativ të Portës së Lartë, ashtu edhe në ngërthimin e arealit shqiptar të Veriut sidomos nën spektrin e influencës politike, ekonomike dhe kulturore të Austro-Hungarisë.³

Falë veprimit të këtij faktori vërejmë pikërisht në këtë periudhë një intensifikim të debatit dhe të hulumtimit albanologjik në disa rrethe intelektualësh e studiuesish austriakë, gjermanë, hungarezë e çekë. Është ky një debat që në një formë a një tjetër e hasim të sendërtuar në veprën e pasur të disa korifенeve të albanologjisë në Perëndim, të tillë si: Johann Georg von Hahn, Franz Miklosich, Gustav Meyer, Kostandin Jireček, Milan Šufflay, Ludwig von Thallóczy, Franz Baron von Nopcsa, Gjergj Pekmezi etj., të cilët e ngritën hulumtimin e mirëfilltë shkencor-albanologjik në të njëjtin nivel me fushat e tjera paralele ndërdisiplinore, si: sllavistika, grecistika, romanistika etj. Pika kulmore të mbështetjes me karakter administrativ-shtetëror të këtij debati i përjetojmë sidomos në vitet 1897 dhe 1908 me themelimin e dy instituteve kërkimore-shkencore, siç janë: Komisioni Ballkanik (= gjerm. "Balkan-Kommission") në Vjenë, përkatësisht Instituti Ballkanik (= "Balkan-Institut" në Sarajevë.⁴

Si na paraqitet gjendja e studimeve albanologjike në Shkodër në këtë periudhë? Sigurisht që as mund të pritej që në këtë qytet sikurse gjithkund në trojet shqiptare të ngriheshin atëbotë institute të mirëfillta hulumtimi shkencor, edhe pse mbështetja politike-kulturore dhe financiare në kuadrin e Protektoratit Kulturor nuk mungoi. E këtë e përcjellim në disa aspekte:

- a) në hapjen dhe përkujdesjen e shkollave publike dhe fetare qysh në mes të shek. të 19-të⁵ të cilat u shoqëruan më pas me

² Zanafilla e këtij procesi do kërkuar në fund të shek. XVII para fillimit të luftës së Lidhjes së Shenjtë [= *Liga Sacra*] kundër Portës së Lartë, pikërisht kur filozofi dhe enciklopedisti gjerman Gottfried Wilhelm Leibnitz i drejtohet me një memorial perandorit të Austro-Hungarisë, Leopoldi I, duke vënë theksin në pozitën e përshtatshme gjeostrategjike e ekonomike-tregtare të Shqipërisë si edhe në dëshirën e popullsisë vendase për të hequr qafe zgjedhën osmane. Shih më hollësish Bardhyl DEMIRAJ 2007 62vv.

³ Shih më hollësish për këtë Engelbert DEUSCH 2009 *passim*.

⁴ Shih më hollësish Kurt GOSTENTSCHNIGG 2010, f. 31vv.

⁵ Shkolla e parë fillore në Shkodër u hap në vitin 1855 nën suazën e Protektoratit Kulturor me mbështetjen financiare të Austro-Hungarisë. Prej vitit 1861 kjo shkollë i kaloi për administrim

themelimin e seminareve dhe kolegjeve fetare të Urdhrit Jezuit dhe Françeskan,⁶ e që së bashku e në harmoni nuk munguan të kultivojnë në programet e tyre mësimore njohjen dhe studimin e shqipes, si edhe të kulturës dhe të historisë së bartësve të saj, duke krijuar kështu kushte më se të përshtatshme edhe për formimin dhe përgatitjen e adeptëve e, për rrjetet e përgatitjeve, për sigurimin e një ecurie normale qoftë në grumbullimin e materialit (gjuhësor e filologjik, etnologjik e arkeologjik, dokumentar-historik etj.), ashtu edhe në sistematizimin, dhe klasifikimin e tij;

- b) në hapjen e shtypshkronjës e njëherësh shtëpisë botuese së "Zojës së Papërlyeme" (1870), e cila zhvilloi për do kohë aktivitetin e saj si i vetmi ent botues në gjithë hapësirën kompakte shqipfolëse duke publikuar rregullisht dhe në vijimësi edhe letërsi të mirëfilltë albanologjike;⁷
- c) në mundësimin e botimit po në vazhdimësi të revistës së parë në gjuhën shqipe në truall shqiptar: "Elçia [/Lajmëtar] e Zemrës së Jezu Krishtit" (1891). Kjo revistë, në pjesën e vet laike, i hapi dyert që në fillim formimit të mirëfilltë intelektual dhe albanologjik të rrethit të lexuesve të saj;⁸
- d) në krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e debatit albanologjik dhe të marrëdhënieve kolegiale që morën formë e hodhën shtat në themelimin e shoqatave kulturore-shkencore "Bashkimi" (1899) dhe "Agimi" (1901), të cilat krahas angazhimit konkret në studimet albanologjike nxitën edhe komunikimin me ata studiues e ato rrethe shkencore-intelektuale në Perëndim, që ishin të interesuara drejtpërdrejt ose tërthorazi në fushën e albanologjisë.

Një vështrim sado i thukët i aktivitetit botues, arsimor e shkencor si edhe i angazhimit social të rretheve intelektuale-fetare që vepruan në Shkodër në këtë periudhë, na lejon të vijmë natyrshëm në përfundimin se bash në këtë qytet u hodhën bazat e albanologjisë shqiptare për një numër disiplinash, si: gjuhësia, filologjia, kritika letrare, etnologjia me

Kuvendit të Fretënvët Françeskanë (Át Donat KURTI 2003 *passim*)

6 Hapja e seminarit të Urdhërit Jezuit në Shkodër (02.08.1859) u shoqërua më pas me hapjen e Kolegit Saverian (Franz-Xaver-Kolleg - 17.10.1877) – shih më hollësish Markus PETERS 2006/7 53vv. dhe 57vv. Kolejet e Urdhrit Françeskan (Troshan, Bajzë, Shkodër - Arra e Madhe) u bashkuan së fundi më 1898 në Kuvendin e Fretënvët në Gjuhadol. Drejtimin e tij e mori më 1902 Át Gjergj Fishta. (Më hollësish Át Donat KURTI 2003 *passim*)

7 Në prag të pavarësisë Át Ndoc Nikaj (1909) hap në Shodër shtypshkronjën e dytë, ndërsa Urdhri Françeskan themelon shtypshkronjën e vet në vitin 1917 (shih Markus PETERS 2006/7 635vv.)

8 Një paraqitje model e paletës tematike të kësaj reviste ofron Markus PETERS 2006/7 103vv.

folkloristikën, historia, arkeologjia etj. Le të marrim për shembëllzim disa syresh:

2. Studimi i shqipes dhe përkujdesja ndaj kulturës së shkrimit shqip
Në rast se përqendrohem i fillimisht në fushën e gjuhësë dhe të leksikografisë nuk e kemi të vështirë të mëtojmë se nuk ndeshim kurrkund në hapësirën kompakte shqipfolëse ose në kolonitë shqiptare në Europë e gjetkë ndonjë qendër simotër, e cila do të arrinte ta konkurronte deri diku atë larmi aktiviteti kulturor-albanologjik që përjetojmë në Shkodër përgjatë gjithë periudhës në fjalë.

2.1 Gramatikat dhe fjalorët e gjuhës shqipe

Ishte pikërisht futja e shqipes në programet shkollore të kohës, që kushtëzoj si reaksiون zinxhir punën për mbledhjen, organizimin dhe klasifikimin e materialit gjuhësor, punë kjo që hedh shtat në botimet në vazhdimesi të disa gramatikave dhe fjalorëve të shqipes. Dhe është fakt që gramatikat e para të gjuhës shqipe që u botuan në truall shqipfolës hedhin rrënje pikërisht në Shkodër pas themelimit të shtypshkronjës së "Zojës së Papërlyeme" (1870). Dallojmë këtu manualin „Regole grammaticali sulla lingua Albanese compilata da P. Giacomo Jungg d. C. d. G.” që u botua në Shkodër në vitin 1880⁹ dhe ka përi autor P. Giacomo Jungg-un, i cili nuk mungon ta theksojë bashkëpunimin kolegjial me Át Engjëll Radojën. Një përqasje sado e përciptë me gramatikat shqipe të botuara gjetkë në këtë periudhë na lejon të mëtojmë edhe parësinë në kohë të këtij botimi në rrjedhën e procesit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.¹⁰

Ky fillim farëmirë shoqërohet me botime të tjera brenda dhe jashtë vendit të gramatikave dhe librave mësimorë të shqipes që kanë autorësinë e studiuesve që vepronin në këtë periudhë në rrethet intelektuale-fetare të Shkodrës. Dallojmë këtu ndër të tjera gramatikat e Át Gaspér Jakovës (1904), Át Anton Xanonit (1909), P. Antonio Busetti-t (1910),¹¹ apo librat ushtrimorë të gjuhës shqipe me autorë P.

9 Kjo vepër ribotohet edhe një vit më vonë me titull të ngjashëm: "Elementi grammaticali della lingua albanese compilati da Giacomo Jungg d.C.d.G., Shkodër 1881.

10 Kemi sjellë përi krahasim këtu botimet e gramatikave të Konstandin Kristoforidhit (Stamboll 1882), të Sami Frashërit (Bukuresht 1886), të Pashko Vasës (Londër 1887); shih më hollësish M. PETERS 2006/7 399. Një botim më të hershëm daton gjithsesi gramatika e fratit franceskan Francesco Rossi da Montalto: "Regole grammaticali della lingua Albanese" (Roma 1866), që veproi përi 13 vjet në dioqezën e Shkupit (Prizren/Kosovë: 1840 - 1853) duke kaluar më pas si lektor i gjuhës shqipe në Kolegjin e Shën Pjetrit në Montorio (Romë/Itali). Shih më hollësish përi këtë albanolog të shquar, të mbetur ende në hipe, pasi nuk ka gjetur ende vend në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, Át Gjergj FISHTA 1937 400vv. Përi tregun e librit në këtë periudhë shih detaje të hollësishme te Armin HETZER 1985 56vv., 68vv., 72vv.

11 Në këtë grupim lejohemi të shtojmë edhe gramatikën e Pashko Vasës (1887)..

Domenico Pasi-n (1889), Gasper Giorgio Benussi-n (1897, 1911) etj.¹²

Një vend të veçantë në punën e mirëfilltë me gjuhën shqipe e hasim në mbledhjen dhe sistematizimin e pasurisë leksikore të shqipes, që sendërtohet në hartimin dhe botimin e fjalorëve dygjuhësh,¹³ ndër të tjerë ata të P. Giacomo Jungg-ut (1895),¹⁴ të Luigj Gurakuqit (1906), të Shoqërisë Bashkimi (1908) e të P. Antonio Busetti-t (1911). E në këtë rast sigurisht nuk bëjmë fjalë thjesht për doracakë ase glosarë fjalësh dosido, por për vepra madhore që i kapërcejnë 1000 faqet e shtypura (Busetti 1911) e sidomos për perla unikale në leksikografinë shqiptare siç është rasti i Fjalorit të Shoqërisë Bashkimi (1908).¹⁵

2.2 Puna ngulmuese për njësimin e kodit alfabetik

Sa i përket çështjes së kodit alfabetik dhe njësimit i tij në kulturën e shkrimit shqip, Shkodra me rrëthet e saj intelektuale-fetare spikasin në këtë periudhë për nivelin e lartë të debatit albanologjik, a) nga njëra anë: duke vijuar traditën e mirë, që zhvillohej prej shekujsh në arealin kulturor të Veriut; e b) nga ana tjeter: duke u orientuar që në fillim drejt risive alternative sa më praktike, të cilat i kushtëzonte teknika e shtypit bashkëkohor. Ky debat është pasqyruar ndërkojë në detaj në letërsinë albanologjike,¹⁶ e cila na përditëson me shumë emra dhe vepra, duke filluar me P. Giuseppe Guagliata-n, P. Giacomo Jungg-un, Át Engjëll Radojën, e duke vijuar me Zef Jubanin, Pashko Vasën, Ndre Mqedën, Luigj Gurakuqin, Át Anton Xanonin, Gjergj Fishtën etj. Angazhimi i tyre social përcjell njëherazi dhundi të moralit qytetar-intelektual shkodran, në të cilin feksin sidomos liria në debat krahas mirëkuptimit në vendimmarrje. Gjithkush mëson sot në shkollë rolin që luajtën Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi e Ndre Mqedha në Kongresin e Manastirit. Se si u priten dhe u tumirën vendimet e kongresistëve atëbotë në rrëthet intelektuale-fetare të Shkodrës këtë e mësojmë ndër të tjera edhe në reagimin publik që bëhet në "Elçia e Zemrës së Jezu Krishtit", ku Át Anton Xanoni i kumton lexuesit ende në kodin e vjetër, se:

"Kena than n'Elçī t'Frorit se na ma uzdaja ci per prill po e çesim Elcīn jo mā me Abē t'perdorueme prei nesh e prei popullit geg deri sod, por me atē ci u pelçye n'Kongres t'Monastirit ci shkoi.

Ket nrrim po e baim me vullnet t'plot e me gjim t'math perse e

¹² Prej këtij autori kemi edhe botimin "Abetore e gjuhësë shqip", Bukuresht 1889 (158 S.)

¹³ Në këtë hulli mund të vështrohet edhe fjalori i Francesco Rossi-t da Montalto, që u botua në Romë më 1875.

¹⁴ Hartuar qysh më 1884; shih Markus PETERS 2006/7 399.

¹⁵ Ky botim fsheh në heshtje pendën dhe autoritetin e D. Dodë Kolecit si redaktori kryesor të tij. Shih më hollësisht Markus PETERS 2006/7 408v.

¹⁶ Shaban DEMIRAJ – Kristaq PRIFTI 2008⁴; Tomor OSMANI 2008²; 2009.

dîm se kso doret po shpeitoim t'bashkuemit e gegve me tosk edhe e rrisin bashkimin e gegve mar. E pranëi çysh me sot na epet me than: Udha mar i kioft alfabetit t'vieter e na rrnoft i riu!; asctû ci sadopak na gegt mos t'kemi sod e mrapa veçse nji Abë ne t'cillen t'a shkrueim e t'a begatoim t'dashtunen e t'bukren giûhen ton." (LZK – Piesa II, 1909: Mars, Nr. III, f. 37)¹⁷

2.3 Ndërķembimi i informacionit dhe i përvojës kërkimore-shkencore

Kjo revistë, në pjesën e vet laike (Pjesa II), përcjell synime të qarta në komunikimin me lexuesin. Informacioni me karakter kulturor-historik dhe enciklopedik merr sigurisht vendin kryesor. Gjithsesi bordi i saj redaksional nuk ngurron të përditësojë lexuesin edhe me informacion albanologjik të mirëfilltë, madje edhe të ndërķembujejë me të përvojën albanologjike të kohës. Artikuj të tillë, si: "Nji shikjim i giuhes shqype" (LZK II 19 [1909] 156-58); "Saa janë Gramatikat e giuhes s' one?" (LZK II 20 [1910] 126-28); "Saa Fialore kaa Shqypia?" (LZK 11 20 (1910) 183-86), na kumtojnë më shumë se një dëshmi të qartë në këtë drejtim. Ata na përditësojnë njëherësh edhe me shkallën e njohjes së debatit gjuhësor albanologjik dhe të ndërķembimit të përvojës kërkimore-shkencore qoftë brendaperbrenda rretheve intelektuale të Shkodrës ashtu edhe midis tyre dhe rretheve të tjera simotra brenda dhe jashtë trojeve shqipfolëse.

Sigurisht që shkëmbimi i informacionit dhe i përvojës kërkimore-shkencore na shfaqet në këtë periudhë edhe në rrugë të tjera, të cilat saktësojnë edhe më mirë nivelin e lartë të debatit albanologjik në rrethet intelektuale të Shkodrës. Një shembull klasik në këtë drejtim na ofron rishtas kontributi i albanologëve shkodranë në gjithë procesin e organizimit të Kongresit Manastirit, për të cilin u kumtua më lart. Për më tepër, këtë nivel e dëshmon nga një tjetër perspektivë edhe komunikimi epistolar mes kolegëve albanologë. I tillë është p.sh. letërkëmbimi i ruajtur për fat të keq i paplotë midis Ndre Mjedës dhe Gustav Meyer-it, i cili vijoi si i tillë e me të njëjtin intensitet edhe pas kthimit të Mjedës në Shqipëri.¹⁸

¹⁷ Teksti me grafinë originale: "Kona ćsan n' Elcii t' Frorit se na ma uedaja ci per Priiħ po e cesim Elcein jo mā me Abeen t' perdorueme prei nesh e prei popułit ghegh deri sod, por me atē ci u pelcy n' Konghres t' Monastirit ci skroi. | Ket nnrtrim po e baim me vuλnet t'plot e me gheim t' maćċ persè e diim se kso doret po scepeitoim t' basckuemit e Ghiegħve me Tosk eż-ze e rrisin bashkimin e Ghiegħve mar. E prannċi cysc me sot na epet me ćsan: Uča mar i kioft alfabetit t'vieter e na rrnoft i riu! asctû ci sadopak na Ghegħt mos t'kemi sod e mrapa vec se gni abee ne t'zilien t'a skrueim e t'a begħatoim t'dashtunen e t'bukren għiūħen t'on." (LZK – Piesa II, 1909: Mars, Nr. III, f. 37)

¹⁸ Përshkrim i hollësishħem i korrespondencës Mjeda-Meyer prej Mentor QUKUT 2006.

3. Fushat e tjera shkencore të albanologjisë

Sigurisht që gjuhësia me disiplinat e saj përshkruese dhe leksikografinë është dhe mbetet një fushë e pëlleshme studimi në qerthullin e debatit albanologjik për gjithë periudhën në fjalë, pikërisht kur Shkodra si qendër kulturore-urbane arriti të konkurrojë denjësisht qendrat e tjera të kulturës shqiptare brenda dhe jashtë hapësirës kompakte shqipfolëse. Sa i përket fushave të tjera të shkencës komplekse të albanologjisë, si: filologjia, kritika letrare dhe kultura popullore, historia e arkeologjia, Shkodra gjëzon me plot gojën statusin e nismëtares.

Mund të veçojmë këtu, ndër të tjera, fillimet e punës filologjike me përmendorët e vjetra të kulturës së shkrimit shqip. Këto fillime i kërkojmë dhe i gjejmë, duke u shtyrë thellë në kohë, shi në fund të viteve 60-të të shek. XIX, kur një studiues albanolog merr përsipër atëbotë tagrin e rëndë të ribotimit të tekstit shqip të Akteve të Kuvendit të Arbënit (Romë 1706). Mjafton një shfletim sado i përciptë i këtij ribotimi (Romë 1868) për të krijuar një përshtypje të parë se kemi të bëjmë me një botim të përkujdesur të tekstit burimor shqip; ndërsa hetimi i detajuar i tij ngjiz fare natyrshëm bindjen se është një botim të mirëfilltë filologjik që për kohën kur u përf tua plotësonte me akribi të spikatur gjithë parametrat e punës filologjike me tekstet e vjetra, një punë kjo, që konsiston:

- në tejskrimin e tekstit me kodin alfabetik bashkëkohor,
- në aparatin filologjik në fund të faqeve,
- në korrigjimin e gabimeve të dukshme të shtypit, apo lajthitjeve të autorit, si edhe
- në shpjegimin e fjalëve të vjetra librore apo të atyre të bjerra njëherë e përgjithmonë nga leksiku aktiv i shqipes me fjalë e shprehje të ligjërimit të përditshëm shkodran.

E jo vetëm kaq: katër vjet më pas – si e kish kuptuar që ky tekst kishte hyrë tashmë në fondin e vyer të kulturës së hershme të shkrimit shqip –, ky studiues albanolog ndërmori edhe rolin e përkthyesit, duke ripërkthyer tekstin original latinisht në ligjërimin bashkëkohor të Shkodërloces (Romë 1872). Ishte bash ky mund dyfish i priftit i shkodran Át Engjell Radojës me tekstet shqip dhe latinisht të Akteve të Kuvendit të Arbënit, që na lejon tash të fiksojmë në pendën dhe autoritetin e tij fillimet e punës së mirëfilltë filologjike me tekstet e vjetra shqip, një punë kjo që në kohën tonë ka arritur vërtet një pikë kulmore në zhvillimin e paradigmës së filologjisë si shkencë albanologjike.¹⁹

Fokusimi në prurjet e rrëtheve intelektuale-fetare të Shkodrës deri

19 Shih më hollësisht Bardhyl DEMIRAJ 2012 5v., 37vv.

në prag të pavarësisë e bën edhe më të dukshëm pozicionin e kësaj qendre kulturore-albanologjike brenda dhe jashtë hapësirës kompakte shqipfolëse. Në Shkodër shkruhet dhe botohet "Historia e Shqypnisë" (Ndoc Nikaj 1902), po ashtu edhe sprova më e parë në fushën e teorisë së letërsisë dhe të kritikës letrare (Át Anton Xanoni 1911/12); në Shkodër mblidhet e ruhet (e më pas sistematizohet e botohet) e drejtë zakonore shqiptare (Shtjefën Gjeçovi)²⁰ e po në Shkodër hedh shtat muzeu i parë arkeologjik shqiptar (1880).²¹ Janë të gjitha këto fusha që plotësojnë duke i dhënë formë të përfunduar paletës ndërdisiplinore të albanologjisë si shkencë komplekse që ka për detyrë të hulumtojë të gjithë komponentët e kulturës etnike të popullit shqiptar.

4. Përfundim

Mbyllim këtu kumtimin tonë duke shpresuar së mundëm të japid një imazh sado të përafërt të rolit udhërrëfyes që mëton Shkodra me rrethet e saj intelektuale në zhvillimin e debatit albanologjik në truall shqipfolës deri në vigilje të shpalljes së pavarësisë; një debat ky, që u orientua qysh në fillim drejt zgjidhjes praktike të atyre nevojave që përcollti vetë mjeti kulturor shkodran i kohës, e që mori formë e u ngjiz falë angazhimit të përgjithshëm social për formim akademik-intelektual. Ishte bash ky angazhim që i mundësoi Shkodrës në këtë periudhë me marrë përsipër tagrin e rëndë të kultivimit të shkencave albanologjike, e për rrjedhojë të sendërtojë si e para qendër albanologjike në trojet shqipfolëse programin kulturor-ideologjik të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Bibliografi

a. Burime të cituara

[Shoqëria] Bashkimi (1908): Fialuer i Rii i Shcypés, përbaam préie Shocniiét t' Bashkimit, Shkodër.

Benussi, Gasper Giorgio (1889): Abetore e giuhësë shqip, Bukarest.

- (1897): Scciyptari i msuem n' ghiuh t'vet prei G. Benussit. E dytë dor godit e sctue prei Bâasit vet. Liber i nevoiscim per sckoła e per popuł (bot. 2-të) Shkodër 1897;
- (1911): Ushtime giûhet shqyp – talian prej G. Benussit. Esercizi di lingua albanese-ital. per G. Benussi, I-II., Shkodër.

Busetti, P. Antonio (1910): Grammatichetta della lingua albanese, Shkodër.

- (1911): Vocabulario Italiano-Albanese compilato dal P. Antonio

²⁰ Shih më hollësish Bardhyl DEMIRAJ [= Vinçenc MĂLAJ] 2012 18vv.

²¹ Shih Markus PETERS 2006/7 641.

- Busetti S.J., Shkodër.
- Gurakuqi, Luigj (1906): Fjalorth shqyp - frangisht e frangisht - shqyp i fjalëve të reja, Napoli.
- Jakova, Át Gaspér (1904): Grammatica della lingua albanese, Frascati.
- Jungg, P. Giacomo (1880): „Regole grammaticali sulla lingua Albanese compilate da P. Giacomo Jungg d. C. d. G.”, Shkodër
- (1881): “Elementi grammaticali della lingua albanese compilati da Giacomo Jungg d.C.d.G., Shkodër.
 - (1895): Fialuur i voghel sccyp e ltinisct mledhun prei Jak Junkut t’ Scocniis Jeeu, Shkodër.
- Nikaj, Ndoc (1902): Historija e Shqypnis, Shkodër.
- Pasi, P. Domenico (1889): Liber per m'u msue me lezue scciyp, Shkodër.
- Radoja, Át Engjell (1868): (1868): Kuvendi i Arbenit o Konçilli Provinciali, mbliedhune mijë shtatçint e tre, ndene Shqiptarin Klementin XI, Papë Pretemadhin. E dyta shtamp. N’Rom.
- (1872): Konçilli i dheut Shqypnis, bamun n’vjet 1703, n’koh t’Paps Shqyptarit, Klementit t’Njimdhetit. Disa emérname, dalun prej Romet mbas Konçillit qì përkasin kishve t’Arbnis. I ka qit shqyp Don Enjell Radoja, prift i Djoçezit Shkodres, N’Rom.
- Rossi da Montalto, Francesco (1866): Regole grammaticali della lingua albanese, Prop. Fide, Roma.
- (1875): Vocabolario della lingua epirotica-italiana / compilato sui vocabolarii Tanfani, Trinchèra ed altri, con tavola sinottica, dal P. Francesco Rossi da Montalto Ligure, Prop. Fide, Roma.
- Vasa, Pashko (1878): L’alphabet latin applique à la langue albanaise, Istanbul.
- (1887): Grammaire albanaise à l’usage de ceux qui désirent apprendre cette langue sans l’aide d’un maître, London.
- Xanoni, Át Anton (1909): Gramatika Shqyp Qi Perdorohet N’Seminarë e n’ Mbësoitore t’ Sh’ Françesk Saverit n’ Shkoder, Shkodër.
- (1909): Alfabeti i rii / Das neue Alphabet [Sachtext]. LZJK II 19 [1909] 37-38.
 - (1909): Nji shikjim i giuhes shqype / Ein Blick auf die albanische Sprache [Sachtext]. LZJK II 19 [1909] 156-58
 - (1910): Saa janë Gramatikat e giûhes s’ one? LZJK II 20 (1910) 126-28.
 - (1910): Çka na duhet nee gramatika? LZJK II 20 [1910] 129-32.
 - (1910): Saa Fialore kaa Shqypia? LZJK 11 20 [1910] 183-86.
 - (1911): Prîisi n’ Lâmë t’ Letratyrës, Shkodër, (Shtojca) LZJK II 21;
 - (1912): Prîisi n’ Lâmë t’ Letratyrës, Shkodër, (Shtojca) LZJK II 22

Letërsi shkencore e cituar

- Demiraj, Bardhyl (2007): "De Albania Occupanda" – çështja shqiptare në Memorialin e një eruditit, në: "Hylli i Dritës" 4 [2007] 62-70, Shkodër.
- (2012): Concili Provintiaali o Cuvendi i Arbenit, Shkodër.
- Demiraj, Shaban – Prifti, Kristaq (2008⁴): Kongresi i Manastirit, Tiranë.
- Deusch, Engelbert (2009): Das Kultusprotektorat Österreich (-Ungarns) im albanischen Siedlungsgebiet in seinem kulturellen, politischen und wirtschaftlichen Umfeld, Böhlau 2009.
- Gostentschnigg, Kurt (2010): Johann Georg von Hahn dhe Albanologjia austrohungareze midis shkencës dhe politikës, në: Johann Georg von Hahn. Akten der Internationalen Konferenz "Nga Gjermanistika në Albanologji: Johann Georg von Hahn, themeluesi i albanologjisë me rastin e 200-vjetorit të lindjes" (Kacadej et al. – botues) Oberhausen.
- Hetzer, Armin (1985): Geschichte des Buchhandels in Albanien. Prolegomena zu einer Literatursoziologie, Berlin.
- Kurti, Át Donat (2003): Provinca Françeskane Shqyptare (E ripertrime në vj. 1906), Shkodër.
- Mullin, Nicholas C. (1972 / 1974): Die Entwicklung eines wissenschaftlichen Spezialgebietes: die Phagen-Gruppe und die Ursprünge der Molekularbiologie, në përmblehdjen "Wissenschaftssoziologie" (bot. Peter Weigart) bl. 2, Frankfurt am Main 1974² (engl. 1972¹).
- Ölberg, Hermann (1982): Die Entwicklung eines Paradigmas, në: "Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft" bl. 50 (Sonderheft), Innsbruck 1982, f. 135-153.
- Osmani, Tomor (2007): Tradita dhe e sotmja në vështrim gjuhësor (Studime), bl. II, Shkodër.
- (2008²): Udha e shkronjave shqipe. Histori e Alfabetit, Tiranë.
 - (2009): Tradita dhe e sotmja në vështrim gjuhësor (Studime), bl. III, Shkodër.
- Peters, Markus W.E. (2006/7): Der älteste Verlag Albaniens und sein Beitrag zu Nationalbewegung, Bildung und Kultur
- Quku, Mentor (2006): Mjeda – Albanologu (1888 – 1899), bl. 2, Tiranë.

Abstract

What is the contribution of Shkodra and its linguists to the cause of Albanology in the Albanian territories until before the Independence?

Demiraj's essay answers this question highlighting the reasons that stand behind such topic. Since the very beginning the cultural mulch in Shkodra showed its bearing on Albanian linguistics and oriented its problematics towards practical solution of fundamental needs of current Albanian language. Consequently, in this town different disciplines of Albanology were cultivated for the first time and the initial ideological and cultural programme of the Albanian Awakening was drawn up as well.